

VENDIM
Nr. 191, datë 15.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK RAJONAL TË GODINAVEDHE TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE,
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8210, ME NUMËR PASURIE 3/74, ME SIPËRFAQE
5 044.85 m², DHE ME NUMËR PASURIE 3/183, ME SIPËRFAQE 1 580.89 m²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5 044.85 (pesë mijë e dyzet e katër pikë tetëdhjetë e pesë) m² dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1 580.89 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë pikë tetëdhjetë e nëntë) m², sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim zhvillimin e projektit “Qendra multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja “Betahaus Të Tirana””.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal dhe kryerëgjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

